# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-456790**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Dua Real Madridin në Champions”/ Intervista e Lamine Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën, pika jona e dobët janë Bayern dhe PSG |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/19/dua-real-madridin-ne-champions-intervista-e-lamine-yamal-si-e-bertitura-e-busquets-me-ndryshoi-jeten-pika-jona-e-dobet-jane-bayern-dhe-psg/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 06:41:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 06:36:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 06:35:00 UTC → 19 shtator 2026, 06:37:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3c04f54b22a522a76c64dca431a06b4d3127baebb7efe1325e2feec5cb24f5da` |
| TEKSTI | `52a5a8317d28079c59e478ea2c296e3dce10e29975eece592251d35f9761dd89` |
| PAMJA | `5e21462954df68c8759ccf5bc207922749459892ec6b00c7992e0a5bb400dbbd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `16fbd5ad0e2461a55f21946db1ad3c85f452f7a2199d851e7dbe1355393aab9c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e49771c1bd8e7ea1d6f74cef9fb8bb705b51ae37158277bf74b8b36f09df048a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/16fbd5ad0e2461a55f21946db1ad3c85f452f7a2199d851e7dbe1355393aab9c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL KRYESORE LA LIGA SPORT TË FUNDIT

# "Dua Real Madridin në Champions"/ Intervista e Lamine Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën, pika jona e dobët janë Bayern dhe PSG

19/09/2026 08:36



**Ylli i Barcelonës, Lamine Yamal, ka folur gjerësisht për karrierën e tij, futbollin dhe objektivat me klubin katalanas në një intervistë për programin "Universo Valdano".**

18-vjeçari u ndal te tema të ndryshme, nga rivaliteti me Real Madridin dhe racizmi në futboll, te Lionel Messi dhe një episod me ish-kapitenin e Barcelonës, Sergio Busquets. Duke folur për "El Clásico", Yamal tregoi se dëshiron që Barcelona të përballet me Real Madridin edhe në Champions League.

Ai kujtoi përballjen e parë të Marcus Rashford në "Santiago Bernabéu", duke theksuar se një futbollist e kupton rëndësinë e këtij dueli vetëm pasi e përjeton. "Me Real Madridin nuk jemi përballur kurrë në Champions dhe do të doja të luanim kundër tyre në Champions", u shpreh Yamal.

Sipas tij, futbollistët që vijnë nga akademia "La Masia" e kuptojnë që në përballjen e parë se çfarë do të thotë një "El Clásico". Yamal foli edhe për racizmin në futboll, një problem me të cilin është përballur edhe vetë në disa stadiume.

"Po bëhen gjëra, por duhet të ketë më shumë seriozitet me disa vendime. Një person që kryen një akt racist dhe që shihet nga të gjithë, nga miliona fëmijë, duhet të dënohet në mënyrën e duhur", deklaroi sulmuesi i Barcelonës.

Ai shtoi se masat kundër racizmit janë të rëndësishme, por mënyra e ndëshkimit duhet të ndryshojë, pasi "është diçka që nuk mund të tolerohet". Yamal pati fjalë të mëdha edhe për Lionel Messin, duke vlerësuar paraqitjen e tij në Botërorin e fituar nga Argjentina.

"Edhe pse të gjithë e dinë se është më i miri në histori, askush nuk e priste një Botëror kaq legjendar nga ai", tha Yamal. Sipas tij, Messi ishte lojtari që shfaqej në momentet vendimtare dhe mbajti peshën kryesore të ekipit argjentinas gjatë turneut.

"Për mua, ai ishte lojtari më i mirë i Botërorit", shtoi ylli i Barcelonës. Sa i përket Champions League, Yamal pranoi se Barcelona përballet me vështirësi më të mëdha ndaj skuadrave fizike si Bayern Munich dhe Paris Saint-Germain.

"Pika jonë e dobët janë më shumë kundërshtarët si Bayern ose PSG, sepse janë më fizikë, të bëjnë të vraposh shumë dhe të qëndrosh i përqendruar gjatë gjithë ndeshjes", tha ai.

Për Arsenalin, ai theksoi se përballja do të ishte më shumë taktike dhe e fokusuar te kontrolli i topit. I pyetur për favoritët në Champions, Yamal përmendi PSG-në, por theksoi se sfida më e madhe pas fitimit të një trofeu është ta fitosh sërish atë.


## SPORT • KRYESORE



Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito



Chelsea dorëzohet pa kushte, Brentford dhuron spektakël në Premier League



Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë



Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë



Mbreti i Mynihut shkruan historinë e Bundesligës, 100 gola në vetëm 98 ndeshje!

## ME TË LEXUARAT

Mancini hap epokën e dytë me Italinë, 9 debutues dhe një rikthim surprizë

Eksodi te Kosova vazhdon, dy lojtarë të tjerë i japin fund aventurës me përfaqësuesen dardane pas Rrahmanit dhe Hadërgjonajt

Yamal tregoi edhe një episod nga fillimet e tij te Barcelona, kur ishte ndëshkuar me kombëtaren për tre javë pas një sjelljeje që ai e cilësoi si "budallallëk fëmijësh".

Në atë periudhë, Sergio Busquets e kishte ndaluar para një seance stërvitore dhe e kishte pyetur se çfarë kishte ndodhur.

"Erdhi seriozisht dhe më pyeti: 'Çfarë ke bërë me kombëtaren?'. Unë isha fëmijë dhe u tremba. I tregova dhe ai më tha: 'Tani je te Barça, të gjithë e dinë kush je dhe nuk ka rëndësi se çfarë lojtari je, duhet të sillesh siç duhet'", rrëfeu Yamal.

Sipas tij, ai moment ishte një pikë kthese. "Që nga ajo kohë e ndryshova jetën time dhe iu përkushtova plotësisht futbollit. Nuk dilja, stërvitesha, luaja, pushoja, shkoja të shihja nënën time dhe vazhdoja. Futboll, futboll dhe vetëm futboll", përfundoi ylli i Barcelonës.

**Top Channel**

## Futboll »



**Ndahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e Interit dhe legjenda e futbollit italian**

19/09 07:20



**Mbreti i Mynihut shkruan historinë e Bundesligës, 100 gola në vetëm 98 ndeshje!**

18/09 23:18



**Chelsea dorëzohet pa kushte, Brentford dhuron spektakël në Premier League**

18/09 22:58



**Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito**

18/09 22:49



**Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë**

18/09 22:47



**Festival në Mynih, Bayern "masakron" Union Berlin me 7 gola**

18/09 22:35

## Kryesore »



**"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle**

19/09 08:26



**Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze**

19/09 08:01



**Trump firmos ligjin e ri kundër Rusisë dhe Iranit, në shënjestër edhe blerësit e naftës ruse**

19/09 07:49



**Arabia Saudite nën alarm pas një shpërthimi të fuqishëm gjatë natës, raportohen probleme me sistemet e navigimit në aeroport**

19/09 07:37



**Ndahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e Interit dhe legjenda e futbollit italian**

19/09 07:20



**SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim**

19/09 07:13

## La Liga »







Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito

Yamal nuk kursehet, sulmon Kane dhe Mbappe: Topi i Artë është për më të mirin, jo për golashënuesin dhe fituesin e Championsit

Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë

Ndërhyrja e Trump dhe çmimi i shpikur, pse Gjermania kërkon shkarkimin e Infantinos

"Kylian do të jetë kapiteni im", Zidane flet për Mbappé, Benzeman dhe Topin e Artë

Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë

Revolucion te Holanda, Xavi Hernandez shpall grumbullimin e tij të parë si timonier i "Tulipanëve"

Bonucci rrëfen prapaskenat, nga refuzimi i Guardiolës, sëmundja e djalit dhe gabimi me Milanin



Yamal nuk kursehet, sulmon Kane dhe Mbappe: Topi i Artë është për më të mirin, jo për golashënuesin dhe fituesin e Championsit

18/09 16:42



Nga polemikat me fanellën te Lamine Yamal, rrëfehet Kylian Mbappe: Ky është viti, Topi i Artë duhet të kthehet në Bernabeu

17/09 15:54



Çmenduri në Barcelonë, 7 gola, tripletë e Raphinhas dhe një fitore spektakolare

16/09 23:32




E vërteta pas skandalit të fanellës që ndezi Spanjën, Mbappé i përgjigjet akuzave: Zemra ime qan për emigrantët

16/09 22:34



Jonathan David gjen qetësinë te Atletico Madrid, kontribuon në fitoren e Los Colchoneros ndaj Osasuina

16/09 21:15



Carlos Espí heroi i Madridit, Reali merr fitoren në frymën e fundit

15/09 23:27

## Sport »



Ndahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e Interit dhe legjenda e futbollit italian

19/09 07:20



Mbreti i Mynihut shkruan historinë e Bundesligës, 100 gola në vetëm 98 ndeshje!

18/09 23:18



Chelsea dorëzohet pa kushte, Brentford dhuron spektakël në Premier League

18/09 22:58



Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito

18/09 22:49



Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë

18/09 22:47



Festival në Mynih, Bayern "masakron" Union Berlin me 7 gola

18/09 22:35

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »




Top Channel/ Protestë madhështore në Prishtinë, mijëra në shesh kundër vendimit të Hagës



Top Channel/ Macron: Do ti përgjigjemi Rusisë për sulmet hibride që po kryen



Top News- Macron paralajmëron Rusinë: Do merrni përgjigje!/ Kush po i bën sulmet hibride në Evropë?








Top Channel/ Rikthehet kriza e Ceutas, mijëra emigrantë janë kthyer në plazhe

Top Channel/ Protesta në ditën e 111, organizatorët kërkojnë vendime të përbashkëta

Top News- Deklasifikohen të tjera dokumente për UFO-t, dalin video e imazhe

**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Topin e kam unë – Apliko tani!
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.